



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR**  
**BERAT**

*Nr.199/6 Rregj.Them.*

*Nr.21 Vendimi*

*Dt. 27.10.2014 Rregj.*

*Berat me, 27.01.2015*

**V E N D I M**

**NE EMER TE REPUBLIKES**

Gjykata e Rrethit Gjyqsor Berat, me trup gjykues te perbere prej :

**GJYQTAR : Agron VAVLA**

asistuar nga sekretare Eftali Shandro, me pjesemarrjen e Prokurore **Eloida Goxhi**, ne seance gjyqesore me dyer te hapura dhe ne daten 27.01.2015 morri ne shqyrtim kerkesen penale qe u perket :

**KERKUESE** : Anila Çobo, e bija Flamur dhe Safigje, me datelindje 11.03.1977, lindur ne Ura Vajguore, Berat dhe banues ne Tirane, njesia bashkiake nr.7, rruga “Irfan Tomini”, 6/258, perfaqesuar nga avokat Ardian Visha.

**OBJEKTI** : Shfuqizimin e vendimit per sekuestrimin e depozitave, date 14.10.2014 te Prokurorise se Rrethit Gjyqsor, Berat

**Baza ligjore** : Nen 212 te K.Pr.Penale.

Ne perfundim te gjykimit kerkuan :

***Kerkuesja, nepermjet perfaqesuesit te saj avokat Ardian Visha*** : Pranimin e kerkeses. Shfuqizimin e vendimit te dates 14.10.2014, heqjen e sekuestros mbi depoziten.

***Prokurorja*** : Rrezimin e kerkeses si te pabazuar ne prova e ligj.

Gjykata pasi shqyrtoi çeshtjen ne teresi, administroi provat shkresore.

**V E R E N**

Kerkuesja Anila Çobo ka paraqitur prane Gjykates se Rrethit Gjyqsor Berat kerkesen penale me numer 199/6, date 27.10.2014, me objekt : Shfuqizimin e vendimit per sekuestrimin e depozitave, date 14.10.2014 te Prokurorise se Rrethit Gjyqsor, Berat

Neni 212 te K.Pr.Penale percakton se, ... *personi tek i cili jane sekuestruar sendet dhe ai qe ka te drejten e ankimit te tyre, mund te bejne ankim ne gjykate kunder vendimit te sekuestrimit.*

Kerkuesja Anila Çobo eshte personi qe i jane sekuestruar sendet e luajtshme, sipas vendimit te

dates 14.10.2014 te Prokurorit. Gjykata kompetente eshte ajo e Rrethit Gjyqesor Berat, pasi vendimi i sekuestrimit eshte marre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Berat.

**Kerkuesja, nepermjet perfagesuesit te saj, avokat Ardian Visha pretendoi se :** Vendimi i dates 14.10.2014 te Prokurorit prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Berat e konsiderojne te pambeshtetur ne ligj, ne prova, ne arsyetim, sepse ;

-Mungesa e arsytimit perben te paren shkelje ligjore te Prokurorit ne vendimarrjen e tij, mbeshtetur ne nenin 208 te K.Pr.Penale, me pasoje shfuqizimin perkates dhe heqjen e sekuestros mbi depozitat ne emer te shtetases Anila Çobo etj.

-Neni 210 te K.Pr.Penale mundeson gjykatën për ndërmarrjen e veprimeve proceduriale për sekuestrim pranë bankave të depozitave bankare dhe çdo gjë tjetër, kur ka arsye të bazuara për të menduar se kanë lidhje me veprën penale. Ky veprim mund të kryet nga Prokurori vetëm në rastet e ngutshme dhe në pamundësi për të pritur vendimarrjen gjyqesore për të realizuar sekuestron. Vendimarrja e Prokurorit është realizuar katër ditë më vonë, çka tregon mungesën e ngutshmerisë në këto rast.

-Aktiviteti i shtetasit Arben Çobo është teresisht i prezumuar. Filtrimi financiar dhe pronësori i gjithë familjes Çobo shtrihet në një afat kohor ndjeshëm të mëparshëm ndeshkimit të tij të prezumuar në Britaninë e Madhe. Veprimi i sekuestros cenon teresinë e anëtarëve të familjes duke injoruar kontributin e tyre të ligjshëm dhjetra vjeçar në formën e pasurisë familjare.

-Pretendimi i konsumimit të vepres penale të pastrimit të parave nepermjet depozitimit bankar të të hollave perben nonsens për mënyrën si ndërtohet neni 287 të K.Penal.

-Eksperti kontabel {.....} ka hetuar financiarisht teresinë e transaksioneve financiare të familjes Çobo, për periudhën vjetore 2000-2014. Sipas këtij akti vërtetohet se asnjë lek, valute apo prone e paluajtshme e kësaj familje nuk është krijuar pa burim të ligjshëm pasurie. Gjithë pasuria e familjes Çobo ka zhvillim legjitim dhe nuk ka vësirë origjinë.

**Prokuroria prapsoi se :** -Mbi bazën e materialit të referuar nga sektori kundër pastrimit të parave në seksionin kundër krimit financiar pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat është rregjistruar procedimi penal numer 1095 e vitit 2014, për veprën penale të „Pastrimit të produkteve të vepres penale“, parashikuar nga neni 287 të K.Penal. Ekzistojnë dyshime se shtetasi Arben Çobo ka tjetërsuar dhe integruar në sistemin financiar fonde nga aktivitete kriminale nepermjet familjareve të tij. Dyshime për shtetasin Arben Çobo kanë lindur bazuar në të dhëna se ai është denuar me vendim gjykatë për pastrim parash në janar 2013 në Britaninë e Madhe.

-Në kushtet e urgjencës është vendosur sekuestrimi i shumës prej 240 000 euro në emer të shtetases Anila Çobo, pranë bankës Societe General Albania, në kuadër të procedimit, e cila është

e motra e shtetasit Arben Çobo. Ekzistojne akte shkresore se si ky shtetas nepermjet familjareve te tij ka integruar ne sistemin financiar fonde nga aktiviteti kriminal. Jane siguruar foto qe tregojne detaje te transaksioneve, ku shtetasi Arben Çobo ka shoqeruar shtetasit {.....} , {.....} ne filialet {.....} dhe {.....} te banka {.....}.

-Te gjitha faktet e detajuara ne dosjen hetimore deri ne keto momente te hetimeve paraprake mbeshtetin dyshimin se shtetasi Arben Çobo nepermjet familjareve te tij ka arritur te vendose e te integroje ne sistemin ekonomiko-ligjor shqiptar fonde te gjeneruara nga veprimtaria e tij kriminale jashte shtetit. Pra shumet e sekuestruara deri tani mbeshtetin dyshimin se mund te jete produkt i nje vepre penale, e cila eshte edhe produkt i te provuarit nga hetimet paraprake.

-Kerkesa e shtetases Anila Çobo eshte e pambeshtetur edhe procedurialisht, duke ju referuar fazes ne te cilen ndodhen hetimet e kesaj çeshtje penale, pasi pasuria e sekuestruar eshte praktikisht dhe objekt i vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale. Prokuroria i eshte drejtuar autoriteteve te drejtesise se Britanise se Madhe me anen e leterporosise per marrjen e provave te nevojshme per arritjen e finalizimit te dyshimit te arsyeshem te bazuar ne prova. Eshte e drejta e hetimit te prokurorit, te vertetoje dyshimin e arsyeshem nese vepra penale ka lidhje me shumen e sekuestruar.

-Mbi bazen e kerkeses se Prokurorit, Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat me vendimin numer 8, date 15.01.2015 ka vendosur sekuestro preventive te llogarise bankare ne emer te shtetases Anila Çobo prane bankes {.....}, me numer llogarie {.....}. Ky vendim nuk ka marre forme te prere. Ky vendim perben mase ndaluese dhe ka epersi mbi vendimin e dates 14.10.2014 te Prokurorit.

***Ne teresi te debatit gjyqesor, provave te shqyrtuara, Gjykata konkludon se kerkesa penale eshte e pabazuar ne ligj dhe prova, dhe si e tille duhet te rezohet, sepse :***

- Me shkresen numer 3176 prot, date 10.10.2014 leshuar nga drejtuesi i Drejtorise se Policise Qarkut Berat eshte derguar ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Berat materiali hetimor ne ngarkim te shtetasve Arben Çobo, Anila Çobo, Flamur Çobo, Safigje Çobo, {.....}, {.....}. Materiali hetimor perbehet nga : informacioni mbi referimin e vepres penale; çertifikat personale dhe familjare te Arben, Anila, Flamur, Safigje Çobo; raporti i ngjarjes. Ky material eshte dorezuar nga oficeri i policise gjyqesore ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Berat ditën e premte, ne datën 10.10.2014, ora 15.00.

Ditën e hene, date 13.10.2014, me shkresen numer 3176/1 prot., eshte derguar material shtese ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Berat, ne vijim te materialeve hetimore te derguara me shkresen numer 3176 prot., date 10.10.2014 ne ngarkim te shtetasve Arben Çobo etj.

Ne datën 13.10.2014, drejtuesi i Prokurorisë ka urdheruar :

*1. Te kryhet regjistrimi i procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të K.Penal, në ngarkim të shtetasve Arben Flamur Çobo, me dtl. 13.02.1980.*

*2. Veprimet hetimore mbi këtë proces penal të kryhen nga prokurorët Eloida Goxhi e Tasim Puci dhe oficeret e policisë gjyqësore Florian Arapi e Kleant Sevdari.*

*3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet zyra e regjistrimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat.*

*4. Urdhërohet zyra e financës në Prokurori për hapjen e partitarit për këtë proces penal.*

-Për datën 13.10.2014 është dita e marrjes së dëgjimit të Prokurorëve Eloida Goxhi dhe Tasim Puci nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Berat për kryerjen e veprimeve hetimore. Nga data 10.10.2013 deri në datën 13.10.2013, para paraqitjes së materialit shtesë me numër 3176/1, datë 13.10.2014 është konsideruar nga Prokurori se nuk ka veprime të ngutshme për sekuestrim pranë bankave.

Për më tej dëgjimit të shtetasit Anila Çobo po mundësohet të tjetërsohet pasurinë e luajtshme në euro të llogarisë rrjedhëse të saj pranë {.....}, dega {.....}, Prokurori vlerësoi se kjo situatë duhet konsideruar „rast i ngutshëm“. Për këtë arsye, në datën 14.10.2014, bazuar në nenin 210 të K.Pr.Penale, Prokurori vendosi :

*1. Sekuestrimin e menjehershëm pranë bankës së përgjithshme të shumes 240.000 euro të depozituara në numrin e llogarisë {.....}, në emër të shtetasit Anila Çobo, e datelindjes 11.03.1977.*

*2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet oficeri i policisë gjyqësore Besnik Tresa, i cili për zbatimin e këtij vendimi duhet të mbajë procesverbal përkatës të cilin duhet ta dorëzojë menjëherë në Prokurori.*

*3. Bazuar në nenin 208/3 të K.Pr.Penale kopja e vendimit t'i komunikohet dhe t'i dorëzohet personi përgjegjës në bankë.*

*4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, brenda dhjetë ditëve nga marrja e dëgjimit.*

Neni 210 të K.Pr.Penale „Sekuestrimi pranë bankave“ përcakton se :

*„Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumentave, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjë tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i perkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në rast të ngutshëm ky vendim mund të merret nga prokurori.*

Ne rastin konkret, ne teresi te materialit hetimor me numer 3176, date 10.10.2014 dhe numer 3176/1, date 13.10.2014, ekzistojne dyshime te bazuara per te menduar se pasuria e luajtshme ne euro te llogarise rrjedhese te shtetases Anila Çobo ka lidhje me vepren penale per te cilen po kryhen hetime paraprake nga Prokurori per shtetasin Arben Çobo. Materiali hetimor, i dhene me shkrim nga oficeri i policise gjyqesore sipas informacionit per referimin e vepres penale tek prokurori, duhet provuar me mundesine e gjetjes apo marrjes se proves. Pra duhet qe ky dyshim i arsyeshem te bazohet ne nje prove te parashikuar ne kreun II, lloji i provave te K.Pr.Penale. Per kete arsye, me anen e nje letre porosie, Prokuroria i ka kerkuar autoriteteve te drejtesise se Britanise se Madhe ndihme per marrjen e dokumentacionit te plote, nese eksiston vendim denimi te formes se prere per shtetasin shqiptar Arben Çobo.

Mbi bazen e ketij arsyetimi si me siper rezohet pretendimi i kerkueses se, “vendimarrja e prokurorit eshte realizuar kater dite me vone, çka tregon mungesen e ngutshmerise, e per pasoje veprimin ekstraprocedural te tij“. Vendimarrja e prokurorit per sekuestrimin e depozitave, date 14.10.2014 eshte marre brenda 24 oreve pas marrjes dijeni nga drejtuesi i prokuroris se eshte urdheruar te kryje veprimet hetimore te ketij procedimi. Kjo vendimarrje eshte konsideruar e ngutshme nga Prokurori edhe nga rendesia e faktit se depozita mund te tjetersohej nga mbajttesi i saj, sepse po te kerkohej ne gjykate do te kalonte te paken nje kohe me e gjate se sa data e vendimarrjes se prokurorit.

-Paraqitja e proves shkesore nga kerkuesja, te aktit te ekspertimit kontabel, per te provuar se shuma e sekuestruar eshte vene nga puna e ligjshme e familjes Çobo perben nje veprim te njeanshem te saj. Kjo prove mund te perdoret apo te paraqitet apo te kerkohet per marrjen e saj gjate hetimeve paraprake. Por ne rastin konkret te kerkeses, me objekt, shfuqizimin e vendimit te sekuestros te dates 14.10.2014 dhene nga Prokurori, kjo prove nuk perben arsye te bazuar per te menduar se shuma e sekuestruar prej 240 000 euro nuk ka lidhje me vepren penale per te cilen po hetohet shtetasi Arben Çobo. Gjithashtu, ne momentin e marrjes se vendimit nga prokurori per sekuestrimin e depozites ne emer te shtetasit Anila Çobo prane bankes {.....}, pasuria e sekuestruar eshte praktikisht dhe objekt i vepres penale per te cilen po vazhdojne hetimet paraprake per te dyshuarin Arben Çobo.

-Ne kete moment proçdural hetimor eshte e drejta e Prokurorit te provoje vepren penale e cila ka lidhje me shumen e sekuestruar. E kunderta, pranimi i mendimit te kerkueses sipas objektit do te sjelle demtime te pariparueshme te hetimeve paraprake dhe sidomos pa provuar nese kjo shume eshte siguruar apo jo nga shtetasi Arben Çobo ne menyre te kundraligjshme. Edhe ky arsyetim rezon pretendimin e kerkueses se marrja e vendimit ka mungese arsyetimi dhe i pabazuar ne

prova. Ne diskutimin perfundimtar Prokurori arsyeton vendimin e dates 14.10.2014 teresisht te bazuar ne ligj dhe prova, duke u bazuar ne teresine e provave te mbledhura deri ne kete moment procedural. Per te mbeshtetur mendimin dhe arsyetimin ne vendimarrje te dates 14.10.2014, Prokurori paraqet vendimin numer 8, date 15.01.2015 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat. Sipas ketij vendimi eshte pranuar kerkesa e prokurorit per marrjen e sekuestros preventive te llogarise bankare ne emer te shtetases Anila Çobo prane bankes {.....}, me numer llogarie {.....}. Ky vendim perben mase sigurimi ndalues, i cili prevalon mbi vendimarrjen e dates 14.10.2014 te Prokurorit. Ne keto kushte per sendin objekt material gjykimi ekziston sekuestro preventive, si mase ndaluese.

Per sa me siper kerkesa penale e shtetases Anila Çobo eshte e pabazuar ne ligj e prova dhe si e tille duhet te rezohet. Shpenzimet gjyqesore si jane bere, ne ngarkim te kerkueses.

#### **PER KETO ARSYE**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat, bazuar ne nenet 210, 212, 379 e vijues te K.Pr.Penale.

#### **VENDOSI**

- Rrezimin e kerkeses penale me numer 199/6 te rregjistrimit themeltar e date rregjistrimi 27.10.2014, si te pabazuar ne prova e ligj.
- Shpenzimet gjyqesore si jane bere, ne ngarkim te kerkueses.
- Kunder vendimit mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore, brenda dhjete diteve duke filluar nga e nesermja e shpalljes.
- *U shpall ne Berat, me 27.01.2015*

**SEKRETARE**  
**Eftali SHANDRO**

**GJYQTAR**  
**Agron VAVLA**